



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0211**  
**Data e Vendimit: 20.03.2024**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “PBC SH.P.K” kundër njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK PRISHTINË”, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 20.03.2024, mori këtë:

## **Vendim**

**I.** Hedhet si e palejuar, ankesa e “PBC SH.P.K” me nr. të protokollit 2024/0211, e datës 13/03/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK PRISHTINË”.

**II.** Lejohet, autoritetit kontraktues – “KK PRISHTINË” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

**III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

### *-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 13.03.2024, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 211/2024 nga OE “PBC SH.P.K” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, inicuar “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 10.01.2024, “KK PRISHTINEË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 22.01.2024.

Me 23.02.2024, “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK.

Me 29.02.2024 OE “PBC SH.P.K” kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 04.03.2024 AK ka hedhur poshtë si të pa lejuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

### *- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, iniciuar nga “KK PRISHTINË” në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK). AK ka publikuar njoftimin- B58 është në sistemin e-prokurimi me datë 23.02.2024.

OE “PBC SH.P.K” kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 29.02.2024 në ora 14:39, parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Me 04.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka hedhur poshtë si të pa lejuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 60 parag 60.1.

### *-Përfundim-*

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtrorj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një*

*kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0) lidhur me nenin 5 të LPP-së.*

Përfundimisht nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 13.03.2024, nga OE “PBC SH.P.K” për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK – “KK PRISHTINË”, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën përrishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit në rrethana të tilla sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së, kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 5, 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por palae pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - PBC SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: